



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punëhoro/Prudato Received/Delivered	10-08-2022	viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHQRTIMI	4645/2022		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.568/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesë me numër A.nr.568/2022 të datës 27.06.2022 të ankuesit me adresë banimi:

kundër organit të punësimit Ministria e Zhvillimit Rajonal, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 10.08.2022, mori këtë.

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.568/2022 e datës 27.06.2022 e parashtruar nga ankuesi

II.MBETET në fuqi, Vendimi i datës 13.06.2022 me numër protokolli:601 i Komisionit për Ngritje në Detyrë i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal.

A r s y e t i m

Ministria e Ministria e Zhvillimit Rajonal me datë 14.02.2022 ka shpallur konkursin për "Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit", në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, mirëpo i njëjti sipas shkresave të lëndës, respektivisht njoftimit të datës 03.06.2022 rezultoi se i njëjti nuk është kandidati fitues. Kundër njoftimit të datës 03.06.2022 ankuesi ka parashtruar ankesë në Komisionin e Vlerësimit për Ngritjen në Detyrë (KVND), ndërsa me datë 13.06.2022 Komisioni i

Vlerësimin për Ngritjen në Detyrë ka nxjerrë vendimin me numër:601 përmes të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar.

Ankuesi kundër vendimin me numër:601 të datës 13.06.2022 të Komisioni i Vlerësimin për Ngritjen në Detyrë të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 27.06.2022 me numër protokoll:568/2022, me pretendimet ankimore se procedura e rekrutimit për pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit", është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës; Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Ligjin Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 30.06.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Zhvillimit Rajonal. Ndërsa me datë 08.07.2022, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 568/2022 e datës 27.06.2022 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 13.06.2022, me numër protokoll:601 i Komisionit për Ngritje në detyrë i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal; Ankesë e datës 07.06.2022 drejtuar Anëtareve të komisionit; Ankesë e datës 01.06.2022, drejtuar Agjencisë kundër korrupsionit; Konkursi i datës 14.02.2022; Njoftimi i datës 11.03.2022;Vendimi i datës 06.05.2022; Përgjigje në kërkesën e datës 06.05.2022; Vendim i datës 15.03.2022, me numër protokoll 364, për formimin e komisionit për vlerësim ngritje në detyrë; Vendimi i datës 08.06.2022; Renditja përfundimtare e kandidateve; Njoftimi i datës 03.06.2022; e- maili i datës 01.07.2022; e- maili i datës 26.05.2022; e- maili i datës 06.05.2022; njoftimi i datës 14.06.2022 për kandidatën e suksesshme; Lista e ngushtë; Testi me shkrim; Testi me shkrim i Kërkesa për punësim e me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 22.10.2008, me numër protokoll 663;Diplomë e datës 20.03.2015, me numër protokoll 657; Diplomë e datës 25.09.2003, me numër protokoll 333;Nrsyshimi dhe plotësimi i Akt Emërimit i datës 25.02.2016; certifikatë e vitit 2014-2016; Formuari për vlerësimin e rezultateve në punë; Vërtetim i datës 10.01.2022; Vërtetim i datës 12.06.2020; Vërtetim i datës 27.08.2018; Vërtetim i datës 25.03.2021; certifikatë e datës 12-13 e muajit mars të vitit 2014; certifikatë e datës 10.03.2010; Kontratë e punës e datës 21.07.2019; Kontratë për marrëveshje shërbime të veçanta e datës 18.10.2018; Kontratë për marrëveshje shërbime të veçanta e datës 24.07.2017; Kërkesa për punësim e me shkresat e bashkangjitura; Vendimi i datës 03.05.2019; Vendim i datës 05.08.2019; Vendim i date19.11.2019;Vendim i datës 19.02.2020; vendim i datës 19.05.2020; vendim i datës 06.08.2020;vendim i datës 06.11.2020; vendim i datës 06.02.2020; Akt emërimi i datës 15.08.2018; Diplomë e datës 01.03.2016, me numër protokoll 5529;Diplomë e datës 19.12.2016, me numër protokoll 1420; Certifikatë e vitit 2022; Kontratë punë e datës 07.10.2015;Mreveshje për shërbime të veçanta e datës 30.03.2018;Aneks marrëveshje e datës 02.07.2018; Formuari për vlerësimin e rezultateve në punë për Vërtetim i datës 04.06.2022; Mirënjohje e datës 23.06.2020; Certifikatë e datës 09.020.2019; Certifikatë e vitit 2017; certifikatën e datës; diplomë e vitit 2010; Letër rekomandim i datës 10.06.2018; E- maili i datës 03.06.2022; Përgjigje në ankesë e datës08.07.2022, me numër

protokolli 3990/2022; Vendimin e datës 01.02.2022 të Z.v Sekretarit të Përgjithshëm; Vendimin e datës 28.09.2020 të Ministrit të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal; Aktin e emërimit të datës 01.04.2013 me numër prot:09.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar në tërsi procedurën e rekrutimit dhe në bazë të shkresave të lëndës ka gjetur se në konkursin e shpallur 14.02.2022 nga Ministria e Zhvillimit Rajonal për pozitën: "Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit", kriteret formale të konkursit kanë qenë: *Diplome Universitare: Fakulteti Ekonomik ose Juridik me të paktën 240 kredi/ECTS-së apo ekuivalente me to; Kualifikimin e posaçme formale; Certifikata e prokurimit; Se paku (5) vite përvojë pune profesionale*, ndërsa në bazë të njoftimit të datës 03.06.2022 të Njesisë për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, rezulton se ankuesi nuk është kandidati fitues.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të shkresave të lëndës respektivisht vendimit të datës 15.03.2022 me numër:364 të nxjerrë nga Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, ka konstatuar Komisioni për Vlerësimin e Ngritjes në Detyrë është themeluar në pajtueshmëri me nenin 59 paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: "2. KVND themelohet nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit, me propozim të NJBNJ. 3. KVND ka në përbërje këta anëtarë: 3.1. një përfaqësues i Njesisë Përgjegjëse (DMZP-ja për institucionet e administratës shtetërore apo Njësia e Burimeve Njerëzore të Institucionit për institucionet e tjera shtetërore) i specializuar në teknikat e përzgjedhjes. 3.2. një përfaqësues nga NJBNJ e vetë institucionit që ka pozitën e lirë; 3.3. një nëpunës civil i kategorisë të lartë drejtuese të vetë institucionit apo të një institucioni tjetër të shërbimit civil, me përgatitje të veçantë në procedurat e përzgjedhjes" pasi që sipas vendimit të datës 28.09.2020 me numër:924 të Ministrit të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal dëshmohet se komisionin e ka themeluar zyrtar më i lartë administrativ respektivisht Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm dhe se dispozitat e kësaj rregulloreje nuk ia ndalojnë të njëjtit të jetë në komisionin e themeluar për Vlerësimin e Ngritjes në Detyrë, po ashtu sipas vendimit të datës 01.02.2022 me numër:32 anëtarja e komisionit e ushtron pozitën e Zëvendësueses së Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore të institucionit që e ka pozitën e lirë si dhe në bazë të Aktit të emërimit të datës 01.04.2013 me numër:9 njëri anëtar i komisionit është nga radhët e ish Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil ish DASHC tani më Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, andaj mbi këtë bazë pretendimet ankimore të ankuesit ndërlidhur me ligjshmërinë e themelimit të Komisionit për Vlerësimin e Ngritjes në Detyrë janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 45 paragrafi 3 ku përcaktohet se: "Në përfundim të verifikimit paraprak NJBNJ përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë. Vetëm këta kandidatë kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin" dhe ka ardhur në përfundimin se me rastin e përgatitjes së listës së kandidatëve të aprovuar me numër reference RMN00008345 Njësia Përgjegjëse ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e kësaj

rregulloreje pasi që sikurse ankuesi edhe kandidatja e përzgjedhur i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret e veçanta të shpallura me konkursin e datës 14.02.2022 nga Ministria e Zhvillimit Rajonal për pozitën e punës: *“Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit”*, respektivisht sipas shkresave të dosjes së kandidatës së përzgjedhur rezultoi se e njëjta i përmbush kriteret për kualifikimin profesional, përvojën e punës dhe certifikimin e kërkuar në fushën e kërkuar pasi që në bazë të diplomës me numër 5529 të datës 01.03.2016 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës *“Hasan Prishtina”* është dëshmuar se kandidatja e përzgjedhur me datë 28.07.2015 ka të kryer Fakulteti Ekonomik në drejtimin Marketing dhe ka marr gradën Bachelor, si dhe në bazë të diplomës me numër 1420 të datës 19.12.2017 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës *“Hasan Prishtina”* e njëjta ka të kryer studimet postdiplomike Master i shkencave Ekonomikë, dhe po ashtu posedon çertifikatën e avancuar të Prokurimit me numër 556 e vitit 2022, si dhe e ka përvojën e punës si në vijim: ku sipas kontratës së punës të lëshuar nga Raffaesien Bank nga data 09.09.2015 deri me datën 08.03.2016 e njëjta ka punuar në pozitën *“Agjente e shitjes”*, ndërsa nga data 01.02.2016 në Kompaninë *“Arbëria Com”* në pozitën *“Asistentë e Kontabilitetit”*, dhe po ashtu nga data 15.08.2018 në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, në pozitën *“Zyrtare e Prokurimit”*, ndërsa sipas vendimeve të Sekretareve Ministrisë së Zhvillimit Rajonal respektivisht Vendimit të datës 03.05.2019 është caktuar U.D e Udhëheqëses së Divizionit të Prokurimit deri me datën 02.08.2019, po ashtu sipas Vendimit të datës 05.08.2019 është caktuar U.D Udhëheqëses së Divizionit të Prokurimit deri me datën 04.11.2019, po ashtu sipas Vendimit të datës 05.11.2019 është caktuar U.D Udhëheqëses së Divizionit të Prokurimit, deri me datë 18.02.2019, po ashtu sipas Vendimit të datës 19.02.2020 është caktuar U.D Udhëheqëses së Divizionit të Prokurimit deri me datën 19.05.2020, po ashtu sipas Vendimit të datës 19.05.2020 është caktuar U.D Udhëheqëses së Divizionit të Prokurimit deri me datën 19.08.2020, po ashtu sipas Vendimit të datës 06.08.2020 është caktuar U.D Udhëheqëses së Divizionit të Prokurimit deri me datën 06.11.2020, po ashtu sipas Vendimit të datës 06.11.2020 është caktuar U.D Udhëheqëses së Divizionit të Prokurimit deri me datën 05.02.2021, po ashtu sipas Vendimit të datës 06.02.2020 është caktuar U.D Udhëheqëses së Divizionit të Prokurimit, deri në zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën Udhëheqëses së Divizionit të Prokurimit.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të shkresave të lëndës respektivisht formularit të datës 02.06.2022 për Renditjen Përfundimtare të kandidatëve, ka konstatuar se për procedurën e cila është kontestuese në këtë rast, Komisioni i Vlerësimit të Ngritjes në Detyrë ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 58 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: *“1.Vlerësimi i kandidatëve, në procedurën e konkurimit për ngritjen në detyrë përfshin, sipas radhës: 1.1. vlerësimin nëpërmjet një testimi me shkrim; 1.2. vlerësimin e jetëshkrimit; dhe 1.3. vlerësimin nëpërmjet një interviste me gojë”*, pasi që sikurse ankuesi edhe kandidatja e përzgjedhur janë vlerësuar në pajtueshmëri me dispozitat e kësaj rregulloreje, respektivisht ankuesi në testin me shkrim ka arritur 41 pikë, ndërsa kandidatja e përzgjedhur 64 pikë, nga vlerësimi i jetëshkrimit ankuesi ka arritur 16 pikë, ndërsa kandidatja e përzgjedhur 18 pikë, nga vlerësimi i intervistës me gojë ankuesi ka arritur 5 pikë, ndërsa kandidatja e përzgjedhur ka arritur 10 pikë, dhe mbi këtë bazë kandidatja e përzgjedhur rezultoi të ketë arritur 92 pikë ndërsa ankuesi 62 pikë, andaj Kolegji i Këshillit konstaton se me rast rekomandimit për emërimin të kandidatës së përzgjedhur e cila ka grumbulluar më shumë pikë sesa ankuesi Komisioni i Vlerësimit për Ngritje në Detyrë në mbështetje të nenit 63 të së njëjtës rregullore ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 48 paragrafi 2 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së



Kosovës ku përcaktohet se : *“Në përfundim të fazës të vlerësimit, pikët e përfituara nga secili kandidat në secilën nga hapat e vlerësimit, mbledhen dhe shuma e pikëve për të gjithë hapat e vlerësimit përbën vlerësimin përfundimtar të konkurrimit”* si dhe nenin 49 paragrafi 2 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: *“Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurrimi. Kandidati fitues në rastin e kandidatëve me pikë të barabarta përcaktohet, nga NJBNJ sipas nenit 27 të kësaj Rregulloreje, dispozitat e të cilit zbatohen përshtatshëm”*.

Kolegji i Këshillit në bazë të shkresave të lëndës ka gjetur se testet me shkrim të datës 30.05.2022 sikurse ai i ankuesit dhe i kandidatës së përzgjedhur identifikohen vetëm përmes kodit të aplikimit dhe nuk përmbajnë të dhëna personale, andaj Kolegji konstaton se ky veprim është në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 60 paragrafi 4 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet: *“Testi me shkrim zhvillohet dhe vlerësohet duke siguruar anonimitetin e kandidatëve”* dhe mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankuesit është i paqëndrueshëm edhe në këtë pikë ngase Komisioni i Vlerësimit për Ngritje në Detyrë vlerësimin e testit me shkrim e bënë mbi bazën e anonimitetit të garantuar të kandidatëve ngase testet me shkrim nuk përmbajnë të dhëna personel të identifikueshme.

Andaj, Kolegji i Këshillit mbi bazën e pasqyrimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi sikurse dhe të gjeturave në shkresat e lëndës ka konstatuar se procedura e zhvilluar për pozitën e punës *“Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit”* në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal ku në bazë të njoftimit të datës 03.06.2022 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore rezulton që kandidatja [redacted] është shpallur kandidatja fituese pasi që kishte arritur të grumbulloi më shumë pikë sesa ankuesi, është zhvilluar në pajtueshmëri me nenin 6 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se : *“1. Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativo teknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive”*, si dhe në pajtim edhe me nenin 4 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *“1. Pranimi dhe avancimi në karrierë në shërbimin civil bazohet në parimet e mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë e proporcional gjinor dhe të pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë. 2. Nëpunësit civil pranohen dhe avancohen në karrierë në bazë të meritës të vlerësuar në bazë të një procedure konkurruese dhe transparente, të përcaktuara në bazë të Ligjit dhe akteve përkatëse nënligjore”*, ndërsa pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendojnë e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Ngritje në detyrë i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal me rastin e nxjerrjes së Vendimi 601 të datës 13.06.2022 përmes të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit të datës 07.06.2022 ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, pasi që ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën

juridike lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën “Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit”, nga Ministria e Zhvillimit Rajonal.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nën 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.568/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.